



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 30.01.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simic, Shkumbin Demaliaj, dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Glauk Konjufca, Sami Kurteshi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Sanije Berisha OSCE; Rreze Hoxha GSJP; Diana Berisha IKD; Nikolla Gjakovic NDI; Rinor Beka NDI; Agnesa Haxhiu KDI.

**Nga Staf i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 12.12.2017 dhe 20.12.2017;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;
4. Njoftim lidhur me mandatin e Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, Bordit Mbikqyrës dhe të anëtarit të Komisionit për kërkesa pronësore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
5. Njoftim lidhur me zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Prokurial të Kosovës;
6. Shqyrtimi i shkresës së avokatëve shtetëror të komunave;
7. Të ndryshme

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja**-Propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika gjashtë që ka të bëjë me shkresën e Avokatëve të Komunave në mënyrë që të shqyrtohet pastaj në një mbledhje të radhës. Gjithashtu njoftoi anëtarët e komisionit se në pikën të ndryshme deputeti Hajdar Beqa do të njoftojë komisionin me planin e veprimit rreth Rregullores së Kuvendit. Gjithashtu tha duhet të diskutohet edhe vendimi i agjencise kunder korrupsion ku konsiderohet i kunderligjshëm vendimin e qeverise për rritje të pagave. Deputetja haxhiu propozoi që të ftohet drejtori i agjencise kunder korrupsion z. shaip havolli në një mbledhje të komisionit për legjislacion apo edhe në grup punues.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 12.12.2017, dhe 20.12.2017;**

**Kryetarja**-konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 12.12.2017 dhe 20.12.2017 pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;**

**Kryetarja**- propozoi si pjesë të planit të punës së komisionit për vitin 2018 të jetë edhe mbikëqyrja e ligjeve, ajo tha se duhet të mbikëqyret ligji për kundervajtje me qëllim që të identifikohen problemet dhe ngecjet që ka ky ligj. Gjithashtu Ligji për Mbikëqyrje Elektronike për personat të cilët janë të liruar me kusht, ajo tha se si komision gjithashtu është mirë të mbështeten edhe propozimet për plotësim ndryshimin e Ligjit për Familjen.

**Korab Sejdiu**- propozoi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Ligjin për Gjykatat kur dihet se ka shumë gjëra që ndodhin në praktikë e të cilat nuk janë në përputhje me këto ligje. Mendoj se është në kompetencën tonë si komision të bëjmë mbikëqyrjen e zbatimit dhe mënyren se si po zbatohen këto ligje theksoi deputeti Korab Sejdiu.

**Kryetarja**-tha, meqenëse deputeti Sejdiu propozoi që plani i punës të plotësohet edhe me mbikëqyrjen e Ligjit për Gjykatat dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, unë po tërhiqem nga mbikëqyrja e Ligjit për Mbikëqyrje Elektronike, pra të ketë vetëm mbikëqyrje të tri ligjeve, Ligji për Gjykata për Gjykatën Kushtetuese dhe Ligjin për Kundërvajtje theksoi deputetja Abulena Haxhiu. Ndërsa sa i përket Ligjit për Familje ajo tha se është nismë e re e Komisionit për Legjislacion.

**Kryetarja**-konstatoi se Komisioni miratoi Planin e Punës së Komisionit për vitin 2018 me ndryshimet e propozuara.

## **4. Njoftim lidhur me mandatin e Drejtorit, Zëvendësdrejtorit, Bordit Mbikqyrës dhe të anëtarit të Komisionit për kërkesa pronësore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës;**

**Kryetarja**- tha se Agjencioni për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është pa Drejtor, pa Zëvendësdrejtor pa Bord dhe pa anëtarin e Komisionit për kërkesa Pronësore. Kryetari i Kuvendit i është adresuar Kryeministrit me një letër që të bëhen propozimet për vendet vakante, por deri tani nuk ka asnjë propozim nga Kryeministri lidhur me këto pozita. Kryetarja propozoi që Komisioni edhe një herë t'i adresohet Kryeministrit në lidhje me këtë çështje në mënyrë që të bëhet plotësimi i këtyre vendeve vakante. Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

## **5. Njoftim lidhur me zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Prokurial të Kosovës;**

**Kryetarja**- njoftoi anëtarët e komisionit në lidhje me tërheqjen z.Rexhep Gashi nga kandidatura për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjithashtu tha se meqenëse ligji kërkon që së paku duhen tre emra, atëherë nominimet duhet të riprocedohen përsëri, tha deputeja Albulena Haxhiu.

## **6. Të ndryshme**

**Hajdar Beqa**-njoftoi anëtarët e komisionit për Rregulloren e Kuvendit për takimin e mbajtur me kryetarët e grupeve parlamentare rreth ecurisë së Rregullores së Kuvendit. Ai tha se u dakorduan që grupet parlamentare të vijn me komente deri me datën gjashtë shkurt edhe pse me plan te veprimt ishte paraparë data 31 janar, që pastaj të harmonizohen ato komente në grupin punues. Ai tha se është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Republikës së Kosovës të ketë një rregullore të re të punës.

**Kryetarja**-tha se si grup i VV jemi dakord që të procedohet tutje Rregullorja e re e Kuvendit kur dihet sa të meta ka rregullorja aktuale. Ajo tha se para se të miratohet në parim mendoj se duhet të ketë një konsensus të subjekteve politike kur dihet se kërkohen 2/3 e deputëtve të kuvendit që të miratohet në parim.

**Bilall Sherifi**- tha, se Grupi Nisma ka komentet në lidhje me draftin e fundit të rregullores, por këto vërejtje do të parqesim në grupin punues gjithsesi. Ai tha se ajo që tani duhet të ndodhë është që partitë politike duhet të arrijnë një konsensus të përbashkët për pjesët që duhet ndryshuar në mënyrë që të shkohet përpara me këtë rregullore.

**Igor Simic**- tha, në emër të grupit Lista Srpska, i bashkëngjitem propozimeve te cilat i ngriti z. Sherifi, d.m.th që para miratimit, të jenë prezent përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare. Kjo rregullore e cila për momentin është ne fuqi, ka mjaftë të meta dhe nisma për plotësimin e saj ka qenë më se e domosdoshme, në anën tjetër ne do parashtrijmë propozimet tona që do jenë pjesë e Rregullores, tha deputeti Simiç.

**Shkumbin Demaliaj**-propozoi që të shqyrtohen vetëm propozimet që vijn nga grupet parlamentare sepse është e panevojshme të shqyrtohet çdo nen i rregullores përsëri.

*Pas diskutimeve komisioni vendosi që të mërkuren me datë 07.02.2018 në ora 10:00 të mblidhet komisioni me pikën e vetme të rendit të ditës, diskutim lidhur me Rregulloren e Kuvendit.*

**Arben Gashi**-ngriti si shqetësim që gjatë punës në komision të caktohet nje hapsirë për media ku ata mund te marrin pamje e jo te ketë lëvizje të kamerave nëpër sallë sepse kjo pastaj po ndikon në mbarvajtjen e punës në komision.

**Hajdar Beqa**-lidhur me shqetësimin deputetit Gashi,tha se me këtë duhet të merret protokolli meqenëse nuk kemi rregullore të komisionit që rregullon këtë çështje.

**Bilall Sherifi**-tha se mbështet shqetësimin e deputetit Gashi,por gjithesei kjo punë duhet të rregullohet në bashkëpunim me mediat deri te një konkluzion i përbashkët në mënyrë që të vazhdohet puna si duhet.

**Korab Sejdiu**-tha se do të ishte mirë që si organ mbikëqyrës t'i sygjerojmë Këshillit Gjyqësor që nëse nuk kanë përbërje të plotë të anëtarëve të kompletohen si përbërje në mënyrë që të mund të funksionojnë si duhet.

Mbledhja përfundoi në orën 14:05

E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

**Albulena Haxhiu**

---